

Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë,20.04.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 14.04.2021 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "**SINJAL shpk**", për aktivitetin: "**Sinjalizimi horizontal dhe vertikal Nr. të Prok: 616 21 023 211 nxjerr:**

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "**Sinjal SHPK**" e datës 14.04.2021 lidhur me aktivitetin e prokurimit "**Sinjalizimi horizontal dhe vertikal Nr. të Prok: 616 21 023 211** kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit , të datës 19.03.2021 të publikuara në web-faqe të KRPP-së.
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë aktivitetin sipas publikimit të datës 19.03.2021.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik "**SINJAL shpk**" me datë 14.04.2021 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Sinjalizimi horizontal dhe vertikal Nr. të Prok: 616 21 023 211**."

Autoriteti Kontraktues, me datë 19 dhe 20.04.2021, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Departamenti i prokurimit ka kërkuar sqarime profesionale nga njesia e kërkesës dhe në bazë të përgjigjeve të tyre konstatojmë se pretendimet tuaja janë të pa bazuara. Argumentimin e Njesisë së kërkesës ua paraqesim në vijim:

-Kamioni për larjen e rrugëve është kërkuar, me qëllim që çdo rrugë apo lokacion ku do të vendoset sinjalizimi horizontal të pastrohet, pas tharjes në sipërfaqe të pastër të vendoset sinjalizimi horizontal. Është cekur në dosje që makina mund të jetë në pronësi apo në shfytëzim me marrëveshje.

-Makina frezë për largimin e sinjalizimit horizontal ku është e domosdoshme, është kërkuar ngase metodat tjera nuk kanë dhënë rezultat të mirë në të kaluarën.

Ju e dini që dyfishimi i sinjalistikës nuk lejohet prandaj është e nevojshme grryerja me makinë adekuate, sipas përshkrimit teknik në dosje.

Grryerja bëhet në ato rrugë apo lokacione ku duhet të fshihet plotësisht sinjalizimi horizontal.

-Për pozicionin 10 dhe 11 Ngjyre plastike një komponentësh akril (sprej) të jete trashesia e vendosjes mbi 0.03 me grimca qelqi, vijë ndarëse e ndërprerë e shiritave të komunikacionit me gjerësi të ketë gjerësi prej 15cm.

-Në ofertë është kërkuar që ngjyra sipas specifikimit teknik në dosje të ketë garancion 24 muaj, për shkak të cilësisë.

-Ne si AK kemi kërkuar për secilën loto sasinë e nevojshme për realizimin e projektit të sinjalizimit Horizontal dhe vertikal në rrugët e Komunës së Prishtinës, kurse ofertat vijnë nga OE që është e drejtë e secilit ofertues.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në sqarimet e paraqitura më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Vendimi i dërgohet parashtruesit të kërkesës , departamentit të prokurimit dhe njësis së kërkesës.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit te ketij vendimi.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit